FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 208

Tiranë – E enjte, 3 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 939, datë 18.11.2015	Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar, 2016 –2018.....	13357

VENDIM
Nr. 939, datë 18.11.2015

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, TË RISHIKUAR, 2016 –2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar, për periudhën 2016 - 2018, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PËRMBLEDHJE

Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2016 – 2018 përbën finalizimin e fazës së dytë, të procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore afatmesme 2016 – 2018, proces ky i iniciuar përmes vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.695, datë 31.07.2015 "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal të rishikuar për periudhën 2016-2018", si dhe vendimit nr.696, datë 31.07.2015 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018".

Si çdo vit, i gjithë procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Manaxhimin Strategjik (GMS), i cili është ngritur në çdo njësi të qeverisjes qendrore në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 08.05.2006, "Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim,'GSBI'", *i ndryshuar*, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore. Në mënyrë të ngjashme, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" dhe udhëzimin nr.8, datë 27.02.2015 "Për përgatitjen e PBA 2016 – 2018 " dhe udhëzimit plotësues nr.8/1, datë 9.07.2015 ""Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 ", është drejtuar dhe organizuar ky proces edhe në institucionet e tjera buxhetore.

Dokumenti i PBA 2016 – 2018 paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të secilës prej Ministrive të Linjës, për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Kështu, ky dokument ka mundur të realizojë për një kuadër afatmesëm lidhjet mes qëllimeve dhe objektivave të politikave, me shpërndarjen e burimeve buxhetore, përkatësisht në nivel programi.

Është e rëndësishme për t'u theksuar fakti se, me rritjen progresive të vëmendjes kushtuar procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016 – 2018, kapaciteti i manaxhimit po përmirësohet vazhdimisht me kalimin e kohës. Gjithashtu, Sistemi i Planifikimit të Integruar dhe veçanërisht Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, janë bazat e forcimit të vazhdueshëm të procesit të PBA, nëpërmjet sigurimit të informacionit të nevojshëm në nivel strategjik të politikave.

Në vijim, projekt- dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm, 2016 – 2018 është i strukturuar në tre kapituj:

- ***Kapitulli i Parë*** përshkruan rolin e PBA, si një instrument i manaxhimit të shpenzimeve publike, pjesë përbërëse e Sistemit të Planifikimit të Integruar, si dhe termat kohorë që procesi i PBA ndjek gjatë vitit buxhetor.
- ***Kapitulli i Dytë*** përshkruan Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal të rishikuar për periudhën 2016 – 2018.
- ***Kapitulli i Tretë*** paraqet në mënyrë të përmbledhur informacionin e siguruar nga Ministritë e Linjës lidhur me Kërkesat Buxhetore Afatmesme 2016 – 2018 dhe konkretisht qëllimet e politikës, objektivat dhe produktet për secilin prej programeve të tyre për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Gjithashtu, në këtë dokument përfshihen edhe 2 anekse shoqëruese të strukturuar si më poshtë:

Aneksi 1: Tavanet e shpenzimeve buxhetore 2016 – 2018 , në nivel programi për Ministritë e Linjës;
Aneksi 2: Tavanet e shpenzimeve buxhetore 2016 – 2018 në nivel grup-artikujsh të shpenzimeve, për çdo njësi të qeverisjes qendrore;

Hyrje

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm

1. Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument operacional për manaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ai është rezultat i dy proceseve: Rishikimit të Politikave dhe Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit. Planet e shpenzimeve hartohen nga njësitë e qeverisjes qendrore brenda burimeve që Qeveria ka në dispozicion. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor.
2. Qëllimet kryesore të PBA janë:
    - *Inkurajimi i efektivitetit, eficencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;*
    - *Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;*
    - *Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;*
    - *Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3- vjeçare).*

Dokumenti i PBA hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Këshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh brenda periudhës afatmesme, që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve publike korrente dhe kapitale.

Gjithashtu, ai i shërben njësive të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre pasi mundëson përcaktimin prej tyre të politikave dhe programeve në një strukturë koherente, si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Duhet theksuar gjithashtu që procesi i hartimit të PBA është i orientuar mbi bazën e performancës. Përparësitë e kësaj mënyre të re të konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsistojnë në përftimin e:

- *Kontributit të qartë të produkteve në përmbushjen e objektivave të politikës;*
- *Produkteve të matshme;*
- *Aktiviteteve të kostueshme.*

Procesi i hartimit të dokumentit të PBA u realizua nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Departamentin e Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe të Ndihmës së Huaj, në Kryeministri dhe Ministrinë e Integrimit. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është përgjegjëse për programimin strategjik dhe monitorimin e investimeve publike. Ajo kontribuon në të gjithë procesin e vlerësimit të investimeve publike duke u kujdesur për t'u reflektuar prioritetet e politikave të qeverisë.

A.2 Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, me një horizont planifikimi prej 7 vitesh, përcakton strategjitë dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata për të gjithë sektorët, bazuar në një vizion kombëtar. Ky program do ti shërbejë edhe arritjes së aspiratave të SKZHI-së për Integrimin Europian.

Për procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016 – 2018, elementi strategjik i PBA u sigurua nëpërmjet konsultimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale përgjatë procesit të Rishikimit të Politikës së Programit – përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për çdo program buxhetor të ministrive të linjës.

A.3 Procesi i Përgatitjes së PBA 2016– 2018

Tabela 1, paraqet në mënyrë të përmbledhur hapat kryesorë në procesin e përgatitjes së PBA 2016 – 2018, të ndërmarrë në përputhje me kalendarin e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe kalendarin e Manaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2015, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.34, datë 21.1.2015.

Tabela 1 Fazat e Përgatitjes së PBA-së

FAZAT	KOHA	PERSHKRIMI
1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioriteteve dhe përgatitja e tavaneve të PBA-së për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale.	Tremujori I	• Përgatitja e tavaneve të përgjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomikë përmes parashikimit makroekonomik • Identifikimi i prioriteteve të politikave dhe zërave me ndikim të rëndësishëm në shpenzime e të ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesorë të investimeve publike) • Vendosja e tavaneve përgatitore të PBA • Përgatitja e Udhëzimit për Përgatitjen e PBA.
Qeveria miraton parashikimin Makro Ekonomik dhe Fiskal, tavanet e përgjithshme dhe tavanet përgatitore të PBA 3-vjeçare për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre		
2. Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)	Tremujori II	• Njësitë e Qeverisjes Qendrore përcaktojnë politikat për çdo program dhe identifikojnë qëllimet dhe objektivat e programit
3. Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)	Tremujori II	• Brenda tavaneve të miratuara, Njësitë e Qeverisjes Qendrore zhvillojnë PSHIP duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet në bazë të fondeve në dispozicion për çdo program
Qeveria miraton projekt -dokumentin e PBA		
4. Përgatitja e Buxhetit	Tremujori III	• Përgatitja e Udhëzimit Plotësues për Përgatitjen e PBA • Njësitë e Qeverisjes Qendrore paraqesin kërkesat buxhetore afatmesme të rishikuara
Qeveria miraton projektin e PBA të rishikuar dhe projektligjin e buxhetit vjetor dhe i dërgon në Kuvend përkatësisht për informim dhe miratim		
5. Shqyrtimi në Kuvend	Tremujori IV	• Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi

Shënim: Dokumenti përfundimtar i PBA publikohet në fillim të vitit pasardhës pas miratimit të ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi

A.3.1 Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)

Nevoja kryesore për një manaxhim efektiv të financave publike është përcaktimi i qartë i politikave. Për politikat e reja kjo mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të një procesi të mirë të përcaktimit të politikave, domethënë nëpërmjet përmirësimit të hartimit të politikave.

Procesi i PBA-së merr një rëndësi parësore në përpjekjet e qeverisë për të lidhur buxhetin vjetor me politikat e tij. Për të arritur këtë, politikat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të rishikohen rregullisht nëpërmjet një procesi të rishikimit të politikës së programit, i cili është i integruar me procesin e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve, përcaktimit të kostove dhe përgatitjes së buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit (PSHIP)

Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit është pjesë e planifikimit strategjik dhe pason Rishikimin e Politikës së Programit. Ai përfaqëson pjesën kryesore të procesit të përgatitjes së PBA. PSHIP ndërmerret në kontekstin e politikës makroekonomike dhe veçanërisht të nevojës për stabilitet fiskal.

Ai realizohet gjithashtu në kontekstin e prioriteteve strategjike të Qeverisë dhe të qëllimeve dhe objektivave të politikës të përcaktuara për çdo sektor, domethënë, nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit, PSHIP reflekton mënyrën se si Qeveria dëshiron t'i alokojë burimet e saj për secilin sektor.

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i PSHIP të jetë në përputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike të Qeverisë është vendosja e tavaneve të shpenzimeve, që përbën kufirin maksimal që mund të shpenzohet ose të planifikohet për t'u shpenzuar, për një qëllim të caktuar. PSHIP ndërmerret nga ministritë e linjës duke përdorur sistemin e informatizuar të Ministrisë së Financës për Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programeve. Për njësitë e qeverisjes qendrore që nuk kanë akses në sistemin e informatizuar, planifikimi i shpenzimeve mundësohet nëpërmjet formateve përkatëse të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

A.4 Roli i Ministrisë së Financave në proçesin e PBA

Roli i Ministrisë së Financave përgjatë procesit të PBA është kryesor dhe shumë i rëndësishëm. Ministria e Financave gjatë fazës së Rishikimit të Politikës së Programit, duhet të sigurojë që politikat, objektivat dhe qëllimet janë të përcaktuara qartë dhe se programet buxhetore dhe rezultatet e synuara do të plotësojnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon vlerë për para që do të thotë përdorim të shpenzimeve publike në mënyrë ekonomike, eficiente dhe efektive.

Ndërsa, roli i Ministrisë së Financave në fazën e Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit është i dyfishtë.

i) Dërgon propozime për Tavanet e Përgjithshme të Shpenzimeve dhe Tavanet Përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave;

ii) Analiza dhe vlerësimi nëse njësitë e qeverisjes qendrore po arrijnë eficiencën, efektivitetin dhe ekonomi në përdorimin e fondeve buxhetore, gjë e cila mbahet në konsideratë gjatë propozimit të Tavaneve Përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave.

A.5 Roli i Komitetit të Planifikimit Strategjik

Komiteti i Planifikimit Strategjik është një strukturë e krijuar pranë Këshillit të Ministrave, e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i këtij Komiteti është thellësisht koordinues dhe vendimmarrës, pasi të gjitha propozimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me Sistemin e Planifikimit të Integruar në përgjithësi, dhe Programit Buxhetor Afatmesëm në veçanti, kalojnë detyrimisht për shqyrtim pranë këtij Komiteti përpara së të marrin miratimin përfundimtar pranë Këshillit të Ministrave.

Në procesin e përgatitjes së PBA, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Këshilli i Ministrave luajnë një rol parësor në drejtim të miratimit të një sërë etapash të rëndësishme të tilla si:

- *Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën e PBA;*
- *Tavanet Përgatitore dhe Përfundimtare të PBA;*
- *Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar;*
- *Projekt Dokumentin e PBA;*
- *Dokumentin e PBA të rishikuar.*

A.6 Buxhetimi Gjinor

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 465 datë 18.07.2012 "Për Integrimin Gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm", Udhëzimin nr.21 datë 21.06.2013 "Për përcaktimin procedurave për Integrimin Gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm", dhe me asistencën teknike të ofruar nga UNWOMEN, gjatë fazës së II të përgatitjes së PBA 2016-2018, u identifikuan **10 programe** të reja buxhetore të cilët kanë planifikuar qëllime, objektiva, produkte, aktivitete e kosto që lidhen me integrimin gjinor. Këto programe të reja i shtohen **9 programeve** buxhetore të identifikuara gjatë fazës së I, duke e çuar në **19 programe** totalin e programeve që përfshijnë buxhetimin gjinor në PBA e tyre. Më konkretisht:

1. Programi "*Zhvillimi Rural duke mbështetur Prodh. Bujqësor Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun*", Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (mbështetja financiare që i jepet fermereve femra)

2. Programi "*Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor"*, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (Informimi dhe këshillimi që i ofrohet fermereve femra)

3. Programi "*Tregu i Punës"*, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (Trainimi profesional I femrave si dhe skemat e nxitjes së punësimit që mbështesin punë-kërkueset femra).

4. Programi "*Përfshirja Sociale*", Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (politika që mbështesin çështjet gjinore)

5. Programi "*Përkujdesi Social*" Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (mbështetje financiare dhe shërbmie për femrat në vështirësi financiare, të abuzuara, si dhe pjesë e grupeve sociale të marxhinalizuara)

6. Programi "*Mbështetja Institucionale për Proçesin e Integrimit*", Ministria e Integrimit Europian (ofrimi i të drejtave dhe mundësive të barabarta në aksesin e informacionit për proceset e integrimit në BE)

7. Programi "*Arti dhe Kultura*", Ministria e Kulturës (ofrimi i mundësive/të drejtave të barabarta në përfitimin prej programeve specifike të mbështetjes së artit dhe kulturës)

8. Programi "*Mbështetje për Zhvillim Ekonomik*", Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (skema të ndryshme të mbështetjes financiare për sipërmarrëset femra)

9. Nën-programi "Shërbimet Mbështetëse", Programi "*Policia e Shtetit*", Ministria e Punëve të Brendshme (ofrimi i mundësive/kushteve të barabarta të punësimit në trupën policore, programet/aktivitetet që mbeshtesin sigurinë dhe mbrojtjen e femrave).

10. Nën-Programi "*Hetimi i Krimeve*" – Programi "Policia e Shtetit", Ministria e Punëve të Brendshme (Parandalimi e lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore në tërësi/gjinisë femërore ne veçanti)

11. Nën-Programi "Siguria Publike" – Programi "Policia e Shtetit", Ministria e Punëve të Brendshme (Parandalimi i rasteve te dhunës ne familje nëpërmjet rritjes se numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për gratë dhe vajzat e dhunuara)

12. Programi "Fonde për Shkencën" – Ministria e Arsimit dhe Sporteve (Mbështetje e diferencuar për kërkueset femra që aplikojnë)

13. Programi "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi" – Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Monitorimi dhe parandalimi i rasteve të diskriminimit të grave në fusha të ndryshme të aktivitetit publik dhe privat)

14. Programi "Sistemi i Burgjeve" – Ministria e Drejtësisë (sigurimi i kushteve optimale për të dënuarat femra, rritja e aftësive të tyre profesionale me synim ri-integrimin e shpejtë të tyre në shoqëri)

15. Programi "Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor" – Ministria e Drejtësisë (Sigurimi i ekzekutimit të plotë të çdo urdhër mbrojtjeje që kanë si objekt gratë)

16. Programi "Planifikimi Urban dhe Strehimi" – Ministria e Zhvillimit Urban (Sigurimi i strehimit të familjeve një-prindërore dhe grave të dhunuara nëpërmjet skemave të ndryshme të strehimit)

17. Programi "Shëndeti Publik" – Ministria e Shëndetësisë (Zgjerimi i shërbimit të depistimit të kancerit të gjirit)

18. Programi “Shërbimet e Kujdesit Parësor” – Ministria e Shëndetësisë (Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore dhe e nënave)

19. Programi “Shërbimet e Kujdesit Dytësor” – Ministria e Shëndetësisë (Ofrimi i shërbimeve cilësore spitalore për pacientet femra)

Procesi i përfshirjes efektive të buxhetimit gjinor në kërkesat buxhetore të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera buxhetore do të vijojë në mënyrë aktive dhe gjatë fazës përgatitore të PBA 2017-2019, duke u fokusuar sidomos në përsosjen e mekanizmave të monitorimit të ecurisë së politikave gjinore të identifikuara nga programet e sipërcituara, ashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së treguesve të performancës për këto programe.

B.Tendencat kryesore të ekonomisë globale

Aktiviteti ekonomik botëror është rekuperuar gradualisht gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Ritmi i zhvillimit ekonomik i vendeve të zhvilluara ka qenë i qëndrueshëm dhe më i lartë se ai i vendeve në zhvillim, por presionet inflacioniste mbeten, në tërësi, të dobëta.Presionet inflacioniste në nivel global mbeten të ndrydhura, ndikuar nga rënia e çmimit të naftës dhe nënprodukteve të saj, gjatë vitit të kaluar. Ecuria në tregjet financiare ka qenë pozitive deri në periudhën qershor-korrik 2015, ku pasiguria u rrit për shkak të rëndimit të situatës financiare në Greqi.
Rritja ekonomike në vendet e zhvilluara është parashikuar në nivelin e 2.1 për qind në vitin 2015 dhe 2.4 për qind në vitin 2016, një përmirësim më gradual sesa ishte parashikuar në prill 2015 në Perspektivën Ekonomike Botërore (World Economic Outlook, WEO). Rritja në vendet në zhvillim parashikohet të ngadalësohet nga 4.6 për qind në vitin 2014 në 4.2 për qind në vitin 2015. Ngadalësimi pasqyron ndikimin uljes së çmimeve të mallrave, kushteve të shtënguara të financimit, tensioneve gjeopolitike dhe rritjes në vendet eksportuese të naftës. Në vitin 2016, rritja ekonomike e vendeve në zhvillim pritet rikuperohet në 4.7 për qind, ndikuar nga rënia e çmimit të naftës, shtrëngimi i kushteve të financimit të jashtëm si rezultat i krizës në Greqi, faktorët strukturorë e ciklikë dhe ndikimi negativ i konflikteve gjeopolitike.

Rimëkëmbja ekonomike në Eurozonë duket në rrugën e duhur, me një rikuperim përgjithësisht të qëndrueshëm të kërkesës së brendshme. Megjithatë përmirësimi ekonomik i Eurozoës mbetet i dobët dhe i segmentuar, pa arritur të përkthehet në përfitime të dukshme në tregun e punës për mjaft nga vendet anëtare. Për këto arsye rritja në vitin 2015 është parashikuar tani të jetë më modeste. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i përshtatur sezonalisht u rrit me 0.4% si Eurozonë ashtu edhe në BE, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Në tremujorin e parë të vitit 2015, PBB u rrit me 0.5% në të dy zonat. Krahasuar me të njëjtin tremujot të një viti më parë PBB-ja u rrit me 1.5% në Eurozonë dhe 1.9% në BE. Sipas zyrës së statistikave të Bashkimit Evropian inflacioni vjetor në Eurozonë ishte -0.1% në shtator 2015, nga 0.1% në muajin gusht (dhe 0.3% në shtator të vitit 2014). Inflacioni vjetor në BE ishte -0.1% në shtator 2015, nga 0.0% në muajin gusht. Në shtator 2015, norma vjetore negative janë vërejtur në shtatëmbëdhjetë vende anëtare. Normat më të ulëta vjetore janë regjistruar në Qipro (-1.9%), Rumani (-1.5%) dhe Spanjë (-1.1%). Normat më të larta vjetore janë regjistruar në Maltë (1.6%), Belgjikë, Portugali dhe Suedi (0.9%).

Rritja e eksporteve, forcimi i konsumit privat dhe rritja e kreditimit, kanë mbështetur në masa të ndryshme ecurinë ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ecuria ekonomike ka qenë përgjithësisht pozitive gjatë tremujorit të parë të vitit edhe për shumicën e vendeve të rajonit, me përjashtim të Serbisë që vijon të regjistrojë tkurrje ekonomike. Kushtet në tregun e punës mbeten problematike në të gjithë rajonin, duke shënuar norma papunësie dyshifrore. Presionet inflacioniste janë të ulëta, por dinamikat e çmimeve janë luhatur dukshëm mes vendeve. Në sektorin bankar, aktiviteti i kreditimit ka shfaqur shenja rigjallërimi, ku norma e rritjes së kredisë është përshpejtuar në shumicën e vendeve dhe standardet e dhënies së kredisë janë lehtësuar, kryesisht ndaj familjeve. Nga ana tjetër, niveli i lartë i kredive me probleme vijon të mbetet problemi kryesor i sektorit bankar në shumicën e vendeve të rajonit. Ekspozimi ekonomik dhe financiar i një pjese të këtij rajoni ndaj Greqisë, mbetet një tjetër rrezik i konsiderueshëm për vijueshmërinë e rimëkëmbjes së tyre ekonomike.

B.1 Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal për Periudhën 2016– 2018

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) i rishikuar për periudhën 2016-2018 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. KMF ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare e atë korente. KMF i rishikuar shërben si bazë për përcaktimin e tavaneve përfundimtare në fazën e dytë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2016 – 2018 në nivel ministrie.

KMF i rishikuar miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin Qershor ose Korrik të çdo viti, pra përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavaneve për shpenzimet i cili rifreskon Kuadrin fillestar të miratuar në Janar të çdo viti dhe mund të jeëtë sërisht subjekt rishikimi dhe përditësimi edhe në muajin Tetor, përpara dërgimit në Parlament të projekt buxhetit të shtetit.

KMF përbehet nga dy komponentë kryesore: (i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomik të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme dhe (ii) parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskal sipas buxhetit të konsoliduar të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2016 – 2018 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhe.

Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Zhvillimet aktuale makroekonomike edhe përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2014 dhe tremujorit të parë të vitit 2015, kanë qenë në linjë me pritshmëritë fillestare. Bazuar në vlerësimet paraprake të Produktit të Brendshëm Bruto Tremujor nga INSTAT, rritja reale për të gjithë vitin 2014 rezultoi 2.1 përqind, ndërsa për tremujorin e parë të 2015 rritja u përshpejtua në 2.8 përqind. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, aktiviteti ekonomik vendas shënoi rritje, si në terma vjetorë ashtu edhe tremujorë, me përkatësisht 2.53% dhe 0.23%. Prodhimi i brendshëm bruto u mbështet si nga zgjerimi i sektorit prodhues, ashtu edhe nga rritja e sektorit të shërbimeve. Sektori prodhues pasqyroi kryesisht performancën e sektorit të **ndërtimit dhe aktivitetit industrial**. Ndërkohë, dinamika e rritjes vjetore e sektorit të shërbimeve rezultoi më e ngadalësuar.

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, struktura e rritjes ekonomike është ushqyer kryesisht nga kërkesa e brendshme, pavarësisht se kjo e fundit e uli kontributin në PBB në krahasim me fundin e vitit të kaluar. Konsumi final i popullsisë dhe ai i qeverisë shënojnë rënie në terma vjetorë, ndaj rritja ekonomike reflekton kryesisht ecurinë pozitive të investimeve (mbështetur nga fluksi i investimeve të huaja direkte). Rritja dyshifrore e formimit bruto të kapitalit fiks mbështeti rritjen e kërkesës së brendshme dhe ishte kontribuesi kryesor i saj. Konsumi privat regjistroi rënie vjetore me 1.2% në tremujorin e parë, duke reflektuar zhvendosjen e burimeve financiare drejt pagimit të faturave të prapambetura të energjisë elektrike, por edhe prirjen e konsumatorëve për të kursyer. Burimet e financimit të konsumit privat u mbështetën nga rritja e remitancave dhe e kredisë konsumatore. Ndërkohë që kërkesa e jashtme vlerësohet të ketë patur një kontribut negativ.

Në tremujorin e dytë të 2015 Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) shënoi nivelin 102.0 duke shënuar një rënie prej 2.7 pikë si në terma vjetorë ashtu edhe në terma tremujorë. Te gjithe nën treguesit e tij pësuan rënie vjetore me përjashtim të treguesit të tregtisë i cili shënoi një rritje vjetore prej 3.1 pikësh. Këto zhvillime tregojnë një rënie të përgjithëshme të besimit gjatë tremujorit të tretë të vitit.

Sipas Anketës së Forcave të Punës, në tremujorin e dytë të 2015 shkalla e papunësisë shënoi nivelin e 17.3 për qind. duke mos pësuar ndryshim në krahasim me tremujorin e kaluar. Ndërsa krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T2-2014), ajo u ul me 0.4 pikë përqindje.

Në kushtet e presioneve të dobëta inflacioniste, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka ruajtur profilin e saj lehtësues. Në gusht 2015, inflacioni vjetor arriti në nivelin 1.9%, ndërsa norma mesatare e inflacionit për periudhën janar-gusht rezultoi në nivelin 1.8%. Luhatjet e inflacionit gjatë gjashtë muajve të parë të vitit kanë reflektuar ecurinë e çmimeve të ushqimeve të papërpunuara. Këto të fundit kanë pasur luhatje të larta në periudhën shkurt – prill të këtij viti, edhe për shkak të përmbytjeve në disa nga zonat e ulëta të vendit. Nga këndvështrimi makroekonomik, rritja e ngadaltë e çmimeve pasqyron efektin e një kërkese të dobët agregate si dhe çmimet relativisht të ulëta në tregjet botërore.

Edhe treguesit financiar suportojnë një vlerësimin për një ecuri disi më dinamike të ekonomisë gjatë gjysmës së parë të 2015. Këtu do të veçohej kredia. Pas një kontraktimi të ndodhur në periudhën korrik 2013 - qershor 2014 në terma vjetor, ky tregues në vijim ka njohur rritje pozitive, ndonëse ende në nivele të moderuara. Stoku i kredisë deri në muajin maj 2015 është rritur me 2.6 përqind krahasuar me majin e 2014. Nga vrojtimi i aktivitetit kreditues për T2 - 2015 vihet re për një lehtësim i standardeve të kredidhënies të aplikuara nga bankat si për bizneset, ashtu edhe për individët, ndërkohë që kërkesa për kredi kryesisht nga bizneset ende vijon të paraqitet e dobët. niveli i kredive me probleme së fundmi ka njohur një rënie të lehtë, një ndryshim pozitiv ky kundrejt një rritje thuajse sistematike që prej fund vitit 2009. Niveli i kredive me probleme deri në tremujorin e parë të vitit 2015 ka zbritur në nivelin e 22.69 përqind, duke shënuar një rënie me 0.08 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2014, ndërsa krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014 ka shënuar një rënie prej 1.39 pikë përqindje. Ndërkohë depozitat kanë vijuar të rriten gjatë gjysmës së parë të këtij viti, duke arritur në 2.9 për qind në muajin maj të këtij viti.

Presionet inflacionite edhe për gjysmën e parë të vitit 2015 kanë vijuar të jenë të dobta, në reflektim edhe të niveleve të ulata të inflacionit të importuar, ndërkohë që monedha vendase ka qëndruar përgjithësisht në të njëjtin nivel kundrejt monedhës evropiane, ndërkohë që njohur një zhvlerësim kundrejt dollarit amerikan në reflektim të konjukturave në tregjet ndërkombëtare të këtyre dy monedhave. Norma mesatare e inflacionit për 6 muajt e parë të vitit 2015 ishte 1.9 përqind.

Zhvillimet në kredi janë karakterizuar nga ritme të ulëta rritje veçanërisht gjatë tre muajve të fundit. Në një këndvështrim më afatgjatë, kjo ecuri është ndikuar nga kërkesa e ulët e bizneseve për kredi dhe nga politikat konservatore të bankave. Me gjithë përmirësimin afatshkurtër, standardet e kreditimit shfaqen të luhatshme dhe në veçanti për bizneset, mbeten ndjeshëm të shtrënguara. Këto të fundit janë huamarrësit që shfaqin nivelin më të lartë të kredive me probleme. Kjo reflektohet edhe tek niveli i kreditimit. Kreditë për individë kanë pësuar rritje gjatë muajve të fundit ndërsa kredia për bizneset vazhdon të thellojë ritmin e rënies. Kredia për sektorin rezident privat shënoi një rritje vjetore prej 2.4% në tremujorin e dytë, duke qenë më e lartë se norma e rritjes vjetore në tremujorin paraardhës (1.9%). Përmirësimi i normave të rritjes ka reflektuar ecurinë e portofolit të kredisë në monedhë vendase. Njëkohësisht, ai është mbështetur nga rritja e portofolit të kredisë për individë. Norma bazë e interesit ka qëndruar në nivelin e 2.25 përqind që prej muajit maj 2014. Cilësia e portofolit të kredisë u përmirësua, ndonëse kreditë me probleme vlerësohet ende në nivele të larta. Niveli i raportit të kredive me probleme konsiderohet ende i lartë. Dinamika e ecurisë së kredive me probleme gjatë periudhës, është reflektuar në rritjen e provigjioneve për rrezikun e kreditit nga ana e sektorit bankar. Në fund të qershorit 2015, raporti i kredive me probleme (RKP) shënoi 20.9%.

Vëllimi i depozitave në sektorin bankar është rritur pavarësisht rënies në normën mesatare të interesit. Kontributin kryesor e ka dhënë monedha e huaj. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2015, depozitat e sektorit bankar shënuan vlerën 1,079 miliardë lekë, duke u rritur me 0.6%, në sajë të kontributit kryesor të ecurisë së depozitave në valutë. Në terma vjetorë, depozitat në sektorin bankar u zgjeruan me 4%. Për depozitat në lek, rritja vjetore shënoi 3.1%, ndërsa për ato në valutë ishte 4.8%. Rreth 50% e depozitave të sektorit janë në valutë, për këtë arsye efekti statistikor i ndryshimit të kursit të këmbimit të lekut është i pranishëm. Normat vjetore të rritjes së depozitave në valute vazhdojnë të jenë më të larta se normat e rritjes në lekë. Përqindja e totalit të depozitave është ulur në muajin gusht në krahasim me muajt e tjerë paraardhës ku ka qenë pothuajse e pandryshuar rreth nivelit 51%. Diferenca mbetet e ngushtë ndërmjet përqindjes së depozitave në lekë dhe atyre në valutë.

Oferta e parasë rezultoi me rritje të qëndrueshme në muajt prill-maj. Agregati i parasë së gjerë, M3, shënoi një normë vjetore rritjeje prej 4.8% në muajin maj, kundrejt normës 4.1% të shënuar në fund të tremujorit të parë. Ecuria pozitive e agregatit M3 ka vijuar të mbështetet gjerësisht nga komponenti valutor (6.6 pikë përqindje). Financimi i qeverisë nga sektori bankar ka dhënë gjithashtu kontribut pozitiv në terma vjetorë (2 pikë përqindje). Kërkesa e sektorit privat për financim vijon të shfaqet e dobët, duke dhënë një kontribut të ulët në krijimin e parasë në ekonomi (1.3 pikë përqindje). Oferta e parasë pritet të zgjerohet me ritme më të larta në pjesën e mbetur të vitit. Krijimi i parasë në ekonomi do të mbështetet kryesisht nga rritja e kredisë për sektorin privat dhe nga flukset valutore nga jashtë. Zgjerimi i depozitave do të marrë kryesisht formën e depozitave në lekë, ndërkohë që pritet një rritje e mëtejshme e depozitave me afat mbi dy vjet. Zhvillimet e pritura monetare janë në linjë me përmirësimin e aktivitetit ekonomik në vend dhe nuk pritet të ushtrojnë presione inflacioniste në horizontin kohor afatmesëm.

Monedha vendase ka qëndruar përgjithësisht në të njëjtin nivel kundrejt monedhës evropiane, ndërkohë që ka njohur një zhvlerësim kundrejt dollarit amerikan në reflektim të konjukturave në tregjet ndërkombëtare të këtyre dy monedhave. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, kursi mesatar i këmbimit lekë/ euro rezultoi 140.4, në rënie të lehtë nga një gjashtëmujor më parë, ndërsa ai lekë/usd rezulton 125.9 nga 108.6 një gjashtëmujor më parë.

Deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve u ngushtua në tremujorin e parë të vitit 2015. Zvogëlimi vjetor me 15% i deficitit tregon një vazhdim të prirjes së nisur gjatë një tremujori më parë. Ecuria e eksporteve neto vlerësohet të ketë dhënë një kontribut pozitiv prej 2.8 pikë përqindjeje në rritjen vjetore të kërkesës agregate. Këtu ndikim të qenësishëm dha rritja vjetore e eksportit real të shërbimeve. Eksportet për periudhën janar – gusht 2015 shënuan rënie prej -3.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ulja e eksporteve është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike”, “Materiale ndërtimi dhe metale”, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqime, pije, duhan”, “Tekstile dhe këpucë” dhe “Produkte kimike dhe plastike”. Konjuktura e pafavorshme ndërkombëtare, sidomos për naftën, duket të jetë arsyeja kryesore e rënies, teksa operatorët nuk kanë interes të prodhojnë e eksportojnë, kur çmimet janë tepër të ulta. Importet e mallrave për periudhën janar – gusht 2015 shënuan rënie 0.6 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ulja e importeve është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike”, “Materiale ndërtimi dhe metale”, “Produkte kimike dhe plastike”. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Tekstile dhe këpucë” dhe “Ushqime, pije, duhan”. Impakti më i madh në rënien e importeve vjen si pasojë e rritjes së prodhimit vendas të energjisë. Gjatë periudhës janar – gusht 2015, bilanci tregtar u përkeqësua me 2.24% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

B.2 Politika fiskale

Politika fiskale për periudhën afatmesme 2016 – 2018 do të jetë e orientuar drejt konsolidimit fiskal ndërkohë që siguron një nivel optimal investimesh mbi 5 përqind të PBB (përfshirë këtu edhe Fondin e Zhvillimit Rajonal si dhe investimet në sektorin e energjisë të financuara nga buxheti i shtetit). Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve të ardhura nga borxhi, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal prej 2.8 përqind të PBB-së për 2016, nga 4 përqind i programuar për vitin 2015, një nivel prej 2 përqind të PBB në 2017 dhe 1.2 përqind e PBB në vitin 2018.

Kjo ulje e deficitit do të bëjë të mundur që niveli i borxhit publik ndaj PBB-së të fillojë të ulet në vitin 2016, për herë të parë që nga viti 2010, duke vijuar uljen graduale edhe në vitet në vijim. Borxhi publik pritet që të bjerë në nivelin e 71.3 përqind e PBB-së për 2016, 69.2 përqind në 2017 dhe në tej në 65.8 përqind në vitin 2018.

Në të njëjtën kohë, ky kuadër fiskal përfshin një sërë politikash buxhetore për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të kompensuar efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike në periudhën afatshkurtër dhe afatmesëm parashikohen të mbahen në të paktën 5 përqind të PBB-së, e cila është e rëndësishme për të ushqyer kërkesën agregate në afat të shkurtër dhe për ta zhvendosur rritjen ekonomike në një nivel të më të lartë në afat të mesëm dhe të gjatë.

B.3 Parashikimet e treguesve makroekonomikë, të të ardhurave dhe shpenzimeve për 2016 - 2018

Rritja reale ekonomike parashikohet që të përshpejtohet gradualisht nga 2.1 përqind që ishte në vitin 2014 në rreth 4.3 përqind në vitin 2018. Rritja ekonomike pritet të mbështetet nga një nivel më i lartë i kërkesës së brendshme, ndërkohë që kërkesa e jashtme neto pritet të ketë një efekt ngadalësues duke faktorizuar edhe efektin e pritshëm të rritjes së importeve si rrjedhojë e projekteve të mëdha energjetike që priten të realizohen gjatë viteve në vijim. Niveli i inflacionit që parashikohet për këtë periudhë është 2.5 përqind për 2016, 2.9 përqind për vitin 2017 dhe 3 përqind vitin 2018.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomik, masave fiskale të ndërmarra, efekteve të pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2016 -2018) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 6.7 përqind në çdo vit.

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomik dhe të të ardhurave për tre vitet në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2016 – 2018 pritet të jenë mesatarisht në rreth 484 miliard Lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 29.7 përqind e PBB. Investimet publike janë parashikuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5 përqind të PBB në çdo vit. Këto konsiderohen nivele optimale për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomik paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur projekt-vendimit. Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëngjitur projekt-vendimit, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB.

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014 Vler.	2015 Para.	2016 Para.	2017 Para.	2018 Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	3.0
Inflacioni (mesatar)	%	2.3	3.6	3.5	2.0	1.9	1.6	2.5	2.8	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	2.4	4.5	2.3	1.0	0.8	1.4	2.5	2.8	3.0	3.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	95.0	103.9	100.9	108.2	105.7	105.2	119.5	119.5	119.5	119.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	131.6	137.7	140.5	139.0	140.3	139.9	141.0	141.0	141.0	141.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit te Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	41.7	44.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5
Rritja reale e PBB	%	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	2.1	3.0	4.0	4.5	4.5
PBB	Lek miliardë	1,143.9	1,239.6	1,300.6	1,335.5	1,364.8	1,413.9	1,492.0	1,596.0	1,717.9	1,848.9
PBB	USD miliardë	12.0	11.9	12.9	12.3	12.9	13.4	12.5	13.4	14.4	15.5
PBB	Euro miliard	8.7	9.0	9.3	9.6	9.7	10.1	10.6	11.3	12.2	13.1
PBB për banor	Lek miië	389.6	424.7	447.4	460.2	470.8	488.2	512.6	545.6	584.4	625.8
PBB për banor	USD	4,101.3	4,086.7	4,433.6	4,253.5	4,454.9	4,642.3	4,289.8	4,566.0	4,890.5	5,237.0
PBB për banor	Euro	2,960.4	3,084.6	3,183.7	3,311.0	3,356.5	3,490.4	3,635.7	3,869.7	4,144.7	4,438.4
PBB për banor	USD-PPP	9,331.2	9,552.6	9,841.4	10,123.2	10,357.4	10,740.9	11,277.5	12,003.4	12,856.5	13,767.4
Norma e papunësisë	%	13.8	14.2	14.3	14.1	17.1	17.3	16.4	15.3	13.9	12.4
Të ardhurat totale	%të PBB	26.1	26.2	25.4	24.7	24.0	26.0	27.8	27.8	27.9	27.9
Shpenzimet totale	%të PBB	33.2	29.3	28.9	28.2	28.9	32.3	31.7	30.3	29.2	28.5
Bilanci i përgjithshëm	%të PBB	-7.1	-3.1	-3.5	-3.4	-4.9	-6.3	-3.9	-2.6	-1.3	-1.0
Bilanci primar fiskal	%të PBB	-3.9	0.3	-0.4	-0.3	-1.7	-3.4	-0.6	0.6	1.7	2.0
Bilanci korrent fiskal	%të PBB	1.3	2.4	1.9	1.2	-0.1	0.9	2.0	3.0	4.0	4.6
Huamarrje totale neto	%të PBB	4.6	3.1	3.5	3.5	4.1	6.2	3.8	2.6	1.3	1.0
Borxhi Publik Total	%të PBB	59.7	57.7	59.4	62.1	70.1	72.0	71.8	68.9	65.7	62.1
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	%të PBB	55.7	54.0	55.7	58.1	61.1	65.2	65.6	63.8	60.6	57.3
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	%të PBB	4.0	3.7	3.7	4.0	9.0	6.9	6.2	5.1	5.1	4.8
Bilanci I llogarisë korrente	%të PBB	-15.3	-11.3	-13.2	-10.2	-10.6	-11.9	-11.8	-12.4	-12.5	-12.3
Bilanci treguar (Mallra & Shërbime)	%të PBB	-24.5	-20.6	-22.8	-18.6	-17.8	-18.3	-18.0	-18.0	-17.5	-16.7
Mallra	%të PBB	-26.5	-23.1	-24.2	-20.8	-17.7	-19.7	-20.2	-20.2	-19.8	-18.9
Eksporte	%të PBB	8.6	13.0	15.2	15.9	18.0	17.1	17.7	18.0	18.3	18.8
Importe	%të PBB	-35.1	-36.1	-39.4	-36.7	-35.7	-36.7	-37.9	-38.2	-38.1	-37.7
Bilanci i pagesave	%të PBB	-0.3	2.0	-0.3	0.8	1.1	2.2	2.1	2.1	2.2	1.9

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR

në milion Lekë

Nr.	E M Ë R T I M I	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015 I Pritshmi	2016 PBA	2017 PBA	2018 PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	**298,981**	**324,721**	**330,469**	**330,384**	**327,178**	**366,686**	**398,210**	**422,984**	**450,946**	**483,453**
I.	**Ndihmat**	**4,430**	**4,605**	**3,811**	**5,559**	**5,737**	**10,092**	**12,000**	**15,000**	**15,100**	**15,800**
	nga te cilat: mbështetje buxhetore nga KE							2,000	4,200	3,300	3,300
II.	**Të ardhura tatimore**	**270,830**	**288,564**	**303,927**	**300,862**	**299,888**	**335,921**	**355,610**	**383,504**	**410,016**	**440,573**
II.1	***Nga tatimet dhe doganat***	**208,870**	**223,019**	**235,509**	**232,591**	**229,031**	**253,534**	**272,358**	**293,012**	**312,758**	**336,096**
1	*Tatimi mbi vlerën e shtuar*	110,062	113,998	119,189	116,533	111,940	123,847	131,203	141,913	152,706	164,831
2	*Tatmi mbi fitimin*	17,149	17,606	19,712	16,853	15,119	21,483	23,547	24,889	26,507	31,336
3	*Akcizat*	33,504	38,788	40,403	36,421	38,151	40,894	44,900	47,947	49,625	51,610
4	*Tatimi mbi të ardhurat personale*	26,820	27,058	27,967	27,989	29,570	28,852	31,803	35,502	37,809	40,418
5	*Taksa nacionale dhe të tjera*	13,405	18,295	21,388	28,677	28,454	32,606	35,582	37,252	40,463	42,169
6	*Taksa doganore*	7,929	7,274	6,850	6,118	5,797	5,852	5,323	5,509	5,647	5,732
II.2	***Të ardhura nga pushteti lokal***	**12,149**	**11,898**	**11,791**	**10,859**	**10,825**	**12,447**	**12,563**	**15,302**	**17,085**	**18,649**
1	*Taksa lokale*	8,154	7,684	7,279	6,210	6,396	7,060	7,066	7,476	7,971	8,532
2	*Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)*	1,509	1,896	1,942	2,506	2,454	3,678	4,017	6,260	7,444	8,330
3	*Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël*	2,486	2,318	2,570	2,143	1,975	1,709	1,480	1,566	1,670	1,787
II.3	***Të ardhura nga fondet speciale***	**49,812**	**53,647**	**56,627**	**57,411**	**60,033**	**69,940**	**70,689**	**75,191**	**80,174**	**85,828**
1	*Sigurimi shoqëror*	44,344	45,041	48,839	49,533	51,064	61,426	59,888	64,303	68,622	73,523
2	*Sigurimi shëndetësor*	5,467	6,432	6,152	6,590	7,410	8,199	9,201	9,888	10,552	11,305
3	*Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve*	0	2,174	1,636	1,288	1,559	315	1,600	1,000	1,000	1,000
III.	**Të ardhura jo-tatimore**	**23,720**	**31,552**	**22,731**	**23,963**	**21,553**	**20,673**	**30,600**	**24,480**	**25,830**	**27,080**
1	*Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë*	6,241	4,936	5,710	4,693	4,628	1,951	962	1,000	1,200	1,500
2	*Të ardhura nga institucionet buxhetore*	9,338	13,994	10,336	10,276	9,987	11,152	20,127	15,500	16,600	17,500
	Të ardhura nga sistemi i arsimit të lartë	0	0	0	0	0	0	3,800	4,200	4,500	4,700
	Të ardhura jo-tatimore të pushtetit vendor	0	0	0	0	0	0	2,600	2,700	2,800	2,800
	Të tjera të ardhura nga inst. buxh për qev. qendrore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	*Dividenti*	374	735	1,060	426	943	1,387	2,011	800	800	800
4	*Tarifat shërbimeve*	4,183	2,977	3,510	3,772	3,133	3,171	3,400	3,400	3,400	3,400
5	*Të tjera*	3,584	8,910	2,115	4,797	2,862	3,012	4,100	3,780	3,830	3,880
	Shitja e H.Dajtit/Hidro Lana-Bregasit	0	4,060	0	2,000	0	0	0	0	0	0
	Shitja e licencave 3G	0	4,352	1,500	500	0	0	0	0	0	0
	Jashtë limitit	0	0	0	0	0	0	1,760	1,850	1,900	2,000
	Të tjera (të rastësisshme)	0	498	615	2,297	0	0	0	1,280	1,330	1,380
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**379,863**	**362,752**	**376,300**	**376,241**	**394,118**	**438,820**	**456,438**	**464,959**	**482,805**	**504,309**
I.	**Shpenzime Korrente**	**283,898**	**300,878**	**305,621**	**312,585**	**328,641**	**341,328**	**367,308**	**385,940**	**398,181**	**414,448**
I.1	***Personeli***	**62,359**	**65,762**	**67,446**	**69,437**	**70,716**	**71,367**	**74,678**	**76,812**	**77,061**	**77,760**
1	*Paga*	53,272	56,951	58,398	60,144	61,087	61,416	63,810	64,412	64,630	65,160
2	*Kontributi për sigurime shoqërore*	9,087	8,811	9,048	9,293	9,629	9,951	10,528	10,900	10,931	11,100
3	*Fondi i veçantë i pagave*							340	1,500	1,500	1,500
4	*Politika të reja pagash*							0	0	0	0
I.2	***Interesat***	**36,301**	**41,604**	**41,121**	**41,498**	**43,335**	**40,075**	**40,900**	**46,531**	**47,954**	**51,083**
1	*Të brendshme*	31,408	35,583	34,253	34,005	35,890	31,834	28,850	33,041	35,282	38,437
2	*Të huaja*	4,893	6,021	6,868	7,492	7,445	8,241	12,050	13,490	12,672	12,646
I.3	***Shpenzime operative e mirëmbajtje, nga të cilat:***	**32,058**	**34,318**	**32,995**	**31,470**	**32,424**	**31,341**	**41,782**	**43,328**	**45,040**	**45,520**
1	*Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)*							37,222	38,478	40,140	40,520
2	*Arsim i lartë*							2,800	3,000	3,000	3,000
3	*Të tjera jashtë limitit*							1,760	1,850	1,900	2,000
I.4	***Subvencionet***	**2,004**	**3,535**	**3,301**	**1,884**	**1,574**	**1,599**	**1,760**	**1,760**	**1,760**	**1,800**
I.5	***Shpenzime për fondet speciale***	**96,725**	**106,207**	**113,894**	**120,269**	**127,644**	**138,534**	**143,262**	**152,457**	**161,309**	**171,400**
1	*Sigurime shoqërore*	73,744	79,316	85,265	89,860	95,598	101,483	106,448	111,643	118,459	126,065
2	*Politika të reja pensionesh*							0	1,170	1,250	1,335
3	*Sigurime shëndetësore*	22,980	25,141	26,974	28,828	30,147	35,734	34,814	36,144	37,600	39,000
4	*Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve*	0	1,750	1,655	1,581	1,899	1,317	2,000	3,500	4,000	5,000
I.6	***Buxheti lokal***	**33,583**	**30,764**	**28,119**	**27,333**	**29,787**	**32,892**	**40,426**	**40,452**	**40,357**	**41,885**
1	*Granti nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor*	21,434	18,866	16,328	16,474	18,962	20,445	12,435	13,000	13,022	12,986
2	*Grante konkuruese/Fondi I Zhvillimit Rajonal*							12,428	9,000	7,000	7,000
3	*Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)*	12,149	11,898	11,791	10,859	10,825	12,447	12,563	15,302	17,085	18,649
4	*Buxheti lokal (të ardhurat nga transferimi i rentës)*							400	450	450	450
5	*Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)*							2,600	2,700	2,800	2,800
I.7	***Transferta të tjera***	**20,867**	**18,688**	**18,745**	**20,694**	**23,161**	**25,520**	**24,500**	**24,600**	**24,700**	**25,000**
1	*Pagesa e papunësisë*	868	982	876	984	800	912	800	1,000	1,000	1,000
2	*Ndihma ekonomike*	16,060	16,706	16,369	18,011	19,370	22,849	20,100	20,000	20,100	20,300
3	*Kompensim për të përndjekurit politikë*	2,200	1,000	1,500	1,699	2,991	1,759	2,000	2,000	2,000	2,100
4	*Kompensim për energjinë elektrike*	0	0	0	0	0	0	1,600	1,600	1,600	1,600
II.	**Fondi rezervë**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**4,900**	**10,840**	**10,347**	**8,736**
1	*Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave*	0	0	0	0	0	0	1,500	1,500	1,500	1,500
2	*Fond kontigjencë për ruajtjen e deficitit*	0	0	0	0	0	0	3,400	9,340	8,847	7,236
III.	**Shpenzime kapitale**	**95,881**	**67,492**	**70,679**	**61,656**	**65,477**	**60,541**	**63,230**	**63,179**	**69,277**	**76,125**
1	*Financimi i brendshëm*	75,600	46,642	41,097	27,398	36,701	33,755	34,238	23,993	31,777	37,925
2	*Financim i brendshëm kontigjencë*							0	0	0	0
3	*Arsim i lartë nga të ardhurat e veta*				0	0	0	1,000	1,200	1,500	1,700
4	*Financimi i huaj*	20,281	20,850	27,982	34,257	28,776	26,786	27,992	37,986	36,000	36,500
IV.	**Detyrimet e prapambetura**						**33,782**	**20,000**			
1	*Detyrimet e infrastrukturës*						9,838	20,000			
2	*Detyrimet tatimore*						12,841	0			
3	*Të tjera*						11,103	0			
V.	**Të tjera**	**85**	**-5,618**	**0**	**2,000**	**0**	**1,669**	**1,000**	**5,000**	**5,000**	**5,000**
3	*Huadhënie neto (sistemi energjitik, etj)*	0	-5,618	0	2,000	0	1,500	1,000	5,000	5,000	5,000
VI.	**Fond shpronesimi**						**1,500**				
	DEFIÇITI	**-80,883**	**-38,031**	**-45,831**	**-45,857**	**-66,940**	**-72,134**	**-58,228**	**-41,974**	**-31,859**	**-20,856**
	FINANCIMI DEFIÇITIT	**80,883**	**38,031**	**45,831**	**45,857**	**66,940**	**72,134**	**58,228**	**41,974**	**31,859**	**20,856**
I.	***I brendshëm***	**70,701**	**13,155**	**26,073**	**26,495**	**56,129**	**42,222**	**48,116**	**26,705**	**38,879**	**32,593**
1	*Të ardhura nga privatizimi*	25,138	411	438	1,221	16,703	35	500	0	0	0
3	*Hua-marrje e brendshme (neto)*	43,339	11,284	28,175	24,783	46,298	38,212	41,616	26,705	38,879	32,593
4	*Të tjera*	2,224	1,460	-2,539	490	-3,399	3,975	6,000	0	0	0
II.	***I huaj***	**10,182**	**24,876**	**19,758**	**19,362**	**10,811**	**29,912**	**10,112**	**15,269**	**-7,020**	**-11,737**
1	*Hua afatgjatë (e marrë)*	15,375	59,793	25,229	32,257	22,354	19,148	60,042	27,186	24,200	24,000
2	*Ndryshimi i gjendjes së arkës*	567	-1,705	2,142	-2,226	1,231	-1,851	0	0	0	0
3	*Ripagesat*	-5,760	-33,212	-7,613	-10,669	-12,774	-17,845	-63,958	-25,917	-31,220	-35,737
4	*Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)*			0			30,460	14,028	14,000	0	
	MEMO:										
